



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlore Sh.A

Adresa: Lagjia “Kushtrimi”, rruga “Arkobaleno” Vlore

E-mail: paolahunda@hotmail.com

Ueb-faq: info@ukv.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Paola Hunda

E-mail paolahunda@hotmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e hapur e thjeshtuar

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes Kuader: Mallra

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin : Ref-48897-05-23-2025

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje vegla pune te ndryshme”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 44511000-5 - Vegla dore

8. Fondi limit: 1,671,900 (nje milion e gjashteqind e shtatedhete e nje mije e nenteqind) **Leke**
pa TVSH

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

Referuar rekomandimeve te ardhura nga APP ne daten 26.05.2025 dhe nga kerkesa per sqarim nga operator ekonomike ne SPE ne daten 27.05.2025.

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _

Bazuar në paragrafin e dytë të pikës 2, të Nenit 75, **Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit**, të ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: *Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.*

Nga kjo cmojme se nuk është e nevojshme shtyrja e afatit kohor për dorezimin e ofertave .

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t’i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

SHTOJCË PËR MODIFIKIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

ISHTE

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, po pa tejkaluar vlerën maksimale të përcaktuar në këtë procedurë, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuar

BËHET

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, po pa tejkaluar vlerën maksimale të përcaktuar në këtë procedurë, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.**
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara**

ISHTE

2.4.2 Furnizuesi duhet që të gjitha materialet t'i shoqërojë me certifikatën e prodhuesit ose me autorizim /deklarate nga prodhuesi , që vërteton përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara.

BËHET

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat e ofertuara . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës

ISHTE

2.4.1 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Me anë të këtij kriteri AK kërkon të sigurohet që mallrat e ofruara (tubo korrogato objekt prokurimi) plotësojnë specifikimet teknike dhe standartet e përcaktuara në DST.

BËHET

2.4.1 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DST , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Me anë të këtij kriteri AK kërkon të sigurohet që mallrat e ofruara (**vegla pune objekt prokurimi**) plotësojnë specifikimet teknike dhe standartet e përcaktuara në DST.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

NJËSIA E PROKURIMIT